Nr: 1399 Prot

dt: 09.04.2026

Miratohet.

FSHE-së!

10.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Universiteti i Shkodrës *"Luigj Gurakuqi"***

**Fakulteti i Shkencave të Edukimit**

**DEKANI**

*Nr.* 311 *prot.* *Shkodër, më* 09.04*.2026*

Lënda: Dërgim i vendimit dhe procesverbalit të komisionit për shqyrtimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin specialist/laborant pranë Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporte.

**REKTORIT TË USH**

Bashkëngjitur po ju dërgojmë vendimin dhe procesverbalin e komisionit për shqyrtimin e dosjeve të aplikantëve për pozicionin specialist/laborant pranë Departamentit të Edukimit Fizik dhe Sporte.

FSHE-së,

Shënim: Të risillen kriteret, me emërtimin e pozicionit UNIFORMANT!

10.04.2026

**DEKANI**

**Prof. As. Dr. Eranda Halluni (Bilali)**

306
07.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Universiteti i Shkodrës *"Luigj Gurakuqi"***

**Fakulteti i Shkencave të Edukimit**

**Departamenti Edukim Fizik dhe Sporte**

*Shkodër, më 07.04.2026*

**VENDIM**

Komisioni i ngritur për konkursin e shpallur nga USH për pozicionin specialist/laborant me kohë të plotë pranë Departamentit Edukim Fizik dhe Sporte, sipas njoftimit të Rektorit nr. Prot. 967/1, datë 3.3.2026, botuar në Buletinin e APP nr. 18, datë 9.3.2026 (faqe 728), i mbledhur me datë 07.04.2026 pas shqyrtimit të dosjeve të aplikantëve:

1. Blerim Bushaj
2. Endri Bushati
3. Fation Kadija

Vendosi:

1. Skualifikimin e kandidatit Blerim Bushaj, sepse ka dorëzuar ka dorëzuar kërkesën për punësim të pafirmosur; gjuhën e huaj fotokopje e panoterizuar. I mungon edhe referenca nga punëdhënësi.
2. Skualifikimin e kandidatit Endri Bushati, sepse ka dorëzuar kërkesën për punësim të pafirmosur; i mungon karta e shëndetit dhe i mungon e referenca nga punëdhënësi i fundit.
3. Skualifikimin e kanditatit Fatjon Kadija, sepse nuk plotëson kriterin e notës mesatare të nivelit të parë Bachelor, sipas kornizës shqiptare të kualifikimeve, niveli 6. Kandidati ka mesataren e këtij niveli 7.18.

**Komisioni**

Dr. Benjamin Naku-kryetar
Dr. Gjulioi Zefi-anëtar
Dr. Nora Deda-anëtare
Dr. Rubin Mandija- përfaqësues i Dekanit
Prof. dr. Mimoza Priku-përfaqësuese e Rektoratit

307
07.04.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**Universiteti i Shkodrës *"Luigj Gurakuqi"***
**Fakulteti i Shkencave të Edukimit**

**Departamenti Edukim Fizik dhe Sporte**

*Shkodër, më 07.04.2026*

PROCESVERBAL

Sot me datë 07.04.2026 u mblodh komisioni ad-hoc për shqyrtimin e dosjeve të aplikantëve për konkursin e shpallur nga USH për pozicionin specialist/laborant me kohë të plotë pranë Departamentit Edukim Fizik dhe Sporte, sipas njoftimit të Rektorit nr. Prot. 967/1, datë 3.3.2026, botuar në Buletinin e APP nr. 18, datë 9.3.2026 (faqe 728). Kryetari i komisionit, pas marrjes së Vendimit të Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit Vendim nr. 5, datë 31.03.2026 për përfaqësuesin e Dekanit, si dhe Urdhrit të Rektorit nr. 40, datë 01.04.2026, ka lajmëruar me e-mail zyrtar të gjithë anëtarët e komisionit për mbledhjen e komisionit dt. 07.04.2026, ora 11.00, pranë FSHE-së.

Dr. B. Naku, në cilësinë e kryetarit të komsionit, ka marrë në dorëzim datë 27.03.2026 dosjet e tre aplikantëve pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore.

Më datë 07.04.2026, ora 11.00 komisioni u mblodh në ambientet e FSHE-së. Kryetari i komisionit lexoi përbërjen e komisionit.

Më pas komisioni nisi punën për fazën e parë, verifikimin e dokumentacionit. Nga pesë aplikantët on-line, vetëm tre prej tyre kishin dorëzuar dosje fizike. Dosjet ishin të mbyllura dhe u hapën në prani të komisionit. Komisioni verifikoi, dokumentacionin e dorëzuar nga tre kandidatët:

1. Blerim Bushaj
2. Endri Bushati
3. Fation Kadija.

Pas verifikimit të dosjeve personale komisioni konstatoi se:

1. Kandidati Blerim Bushaj ka dorëzuar kërkesë për punësim të pafirmosur. Gjuha e huaj është vetëm një fotokopje dhe nuk është as dëshmia origjinale apo e noterizuar. Sipas Vërtetimit të marrë në Tatim Taksa, ai rezulton i punësuar, por i mungon letra e referencës nga punëdhënësi.
2. Kandidati Endri Bushati ka dorëzuar kërkesë për punësim të pafirmosur, ka mungesë të kartës së shëndetit. Sipas vërtetimit të marrë në e-Albania rezulton i punësuar me shkëputje për periudhën 2016-2024, por mungon letra e referencës nga punëdhënësi.
3. Kandidati Fatjon Kadija ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar.
4. Kanditati Fatjon Kadija nuk plotëson kriterin e notës mesatare të nivelit të parë Bachelor, sipas kornizës shqiptare të kualifikimeve, niveli 6. Kandidati ka mesataren e këtij niveli 7.18.

Duke qenë se asnjëri nga kandidatë, nuk i plotëson kushtet, komisioni nuk kualifikoi asnjë prej kandidatëve në fazën tjetër.

Kryetari i komisionit do të bëjë lajmërimin me e-mail të kandidatëve.

**Komisioni**

Dr. Benjamin Naku-kryetar
Dr. Gjulioi Zefi-anëtar
Dr. Nora Deda-anëtare
Dr. Rubin Mandija- përfaqësues i Dekanit
Prof. dr. Mimoza Priku-përfaqësuese e Rektoratit